



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 143

Tiranë – E martë, 3 tetor 2023

## PËRMBAJTJA

	Paqe
Ligj nr. 74/2023, datë 14.9.2023	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2022 për projektin “Ekonomia qarkulluese për zhvillimin e qëndrueshëm urban në Shqipëri”..... 16007
Dekret i Presidentit nr. 259, datë 29.9.2023	Për shpallje ligji..... 16009
Dekret i Presidentit nr. 233, datë 25.9.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 16009
Dekret i Presidentit nr. 234, datë 25.9.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 16009
Dekret i Presidentit nr. 235, datë 25.9.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 16009
Dekret i Presidentit nr. 236, datë 25.9.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 16010
Dekret i Presidentit nr. 237, datë 25.9.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 16010
Dekret i Presidentit nr. 238, datë 25.9.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 16010
Dekret i Presidentit nr. 239, datë 25.9.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 16011
Dekret i Presidentit nr. 240, datë 25.9.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 16011
Dekret i Presidentit nr. 241, datë 25.9.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 16011
Dekret i Presidentit nr. 242, datë 25.9.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 16012

Dekret i Presidentit nr. 243, datë 25.9.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	16012
Dekret i Presidentit nr. 244, datë 25.9.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16012
Dekret i Presidentit nr. 245, datë 25.9.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16012
Dekret i Presidentit nr. 246, datë 25.9.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16013
Dekret i Presidentit nr. 247, datë 25.9.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16013
Dekret i Presidentit nr. 248, datë 27.9.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16013
Dekret i Presidentit nr. 249, datë 27.9.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16014
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 546, datë 28.9.2023	Për lirim nga detyra.....	16014
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 547, datë 28.9.2023	Për miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore të GIS-it kombëtar”	16014
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 548, datë 28.9.2023	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 6.7.2023, për çështjen “Elgakoti sh.p.k. dhe të tjerë kundër Shqipërisë” (për kërkesën nr. 63986/10 dhe 5 kërkesa të tjera)	16030
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 549, datë 28.9.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Projekt i Parkut Ujor Tushemisht – Drilon, Bashkia Pogradec”.....	16031
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 550, datë 28.9.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim rruga lidhëse e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA), autostrada Fier–Vlorë”.....	16035
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 551, datë 28.9.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Krijimi i një parkimi makinash pranë Urës së Vjetër të Goricës”, Bashkia Berat	16037
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 552, datë 28.9.2023	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar.....	16038
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 281/16, datë 28.9.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i përroit Lushnjë dhe rikualifikimi urban i zonave rreth tij”	16041



**LIGJ**  
**Nr. 74/2023**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË**  
**REPUBLIKËS FEDERALE**  
**TË GJERMANISË PËR**  
**BASHKËPUNIMIN TEKNIK 2022 PËR**  
**PROJEKTIN “EKONOMIA**  
**QARKULLUESE PËR ZHVILLIMIN E**  
**QËNDRUESHËM URBAN**  
**NË SHQIPËRI”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2022 për projektin “Ekonomia qarkulluese për zhvillimin e qëndrueshëm urban në Shqipëri”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.9.2023.

**Shpallur me dekretin nr. 259, datë 29.9.2023 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.**

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE**  
**QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË**  
**GJERMANISË MBI BASHKËPUNIMIN**  
**TEKNIK 2022**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale e Gjermanisë, në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit teknik si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social, ekonomik dhe mjedisor në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar premtimit financiar të Republikës Federale të Gjermanisë (nota verbale nr. 181/2022, datë 31 gusht 2022),

kanë rënë dakord si vijon:

**Neni 1**

1. Në zbatim të Marrëveshjes së datës 21 tetor 1988 mbi bashkëpunimin teknik ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë do të mbështetet projekti i mëposhtëm:

“Ekonomia qarkulluese për zhvillimin e qëndrueshëm urban në Shqipëri”,

nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar, se ky projekt vlen për t'u mbështetur.

2. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për projektin e përmendur në paragrafin 1 shërbime në personel dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi në një vlerë të përgjithshme deri gjithsej 6.500.000,00 euro (me fjalë: gjashtë milionë e pesëqind mijë euro). Ajo ngarkon me zbatimin e projektit të përmendur në paragrafin 1 Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (*Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit - GIZ*).

3. Kjo marrëveshje vlen edhe për shtesa fondesh - si dhe për bashkëfinancime nga donatorë të tjerë - për projektin e përmendur në paragrafin 1, sikundër edhe për masa të tjera vijuese, nëse qeveritë e dy vendeve tona do të duan ta mbështesin më tej këtë



projekt. Premtimet financiare të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për masa vijuese dhe shtesa fondesh për projekte bëhen të ditura përmes njoftimesh zyrtare nga ana e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, e cila i referohet tekstualisht kësaj marrëveshjeje. Në këto raste vlejné afate të ndryshme nga neni 2, paragrafi 2, të cilave do t'u referohet specifikisht njoftimi i Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë.

#### Neni 2

1. Hollësitë e projektit të përmendur në nenin 1, paragrafi 1, si dhe ato mbi detyrimet dhe shërbimet, që duhet të kryhen, do të përcaktohen në kontrata të veçanta zbatimi dhe eventualisht financimi, të cilat do të lidhen ndërmjet institucioneve në kuptimin e nenit 1, paragrafi 2 dhe atyre institucioneve, të cilat do të ngarkohen nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë me zbatimin e projektit. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton, që institucionet e ngarkuara prej tij me zbatimin e projektit të kryejné shërbimet e nevojshme për projektin e përmendur në nenin 1, paragrafi 1. Në mënyrë të veçantë, ai garanton edhe për shërbimet partnere të përcaktuara konkretisht në kontratat e zbatimit dhe eventualisht ato të financimit.

2. Premtimet financiare për projektin e përmendur në nenin 1, paragrafi 1, do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se brenda pesë vjetëve pas vitit të premtimit financiar nuk janë lidhur ende kontratat përkatëse të zbatimit dhe eventualisht ato të financimit të përmendura në paragrafin 1. Për këto shuma afati përfundon me mbarimin e datës 30 gusht 2027. Nëse kontratat e përmendura në paragrafin 1 lidhen brenda afatit të parashikuar vetëm për një pjesë të premtimit financiar, atëherë kjo klauzolë zhvlerësimi vlen vetëm për atë pjesë të fondeve, që nuk është ende objekt i këtyre kontratave.

#### Neni 3

1. Dispozitat e Marrëveshjes Kuadër të përmendura në nenin 1 paragrafi 1, vlejné edhe për këtë marrëveshje.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton organizatën zbatuese të projektit nga të gjitha taksat dhe tatimet direkte, që lindin në

Republikën e Shqipërisë në kontekstin e projektit të përmendur në nenin 1, paragrafi 1, si dhe në kontekstin e lidhjes dhe të zbatimit të kontratave të zbatimit dhe eventualisht financimit të përmendura në nenin 2, paragrafi 1.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë përjashton materialet e importuara me porosi të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë - përfshirë këtu pajisjet dhe automjetet - nga të gjitha detyrimet e importit dhe të eksportit, detyrimet portuale dhe të magazinimit, si dhe nga taksat e tjera publike, sikurse garanton zhdoganimin e tyre pa vonesë.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përjashton nga TVSH-ja apo tatime të ngjashme indirekte të vendosura në Republikën e Shqipërisë, materialet e siguruara apo shërbimet e shfrytëzuara nga organizata gjermane zbatuese, në kuadër të projektit të përmendur në nenin 1, paragrafi 1. Përjashtimi prej këtyre detyrimeve mund të kryhet në formën e rimbursimit apo të heqjes së këtyre taksave.

#### Neni 4

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

2. Kjo marrëveshje lidhet me një afat të pacaktuar. Secila palë kontraktuese mund ta shfuqizojë atë në çdo kohë me shkrim në rrugë diplomatike. Zgjidhja e Marrëveshjes bëhet efektive ditën e parë të muajit, që vijon, pas një periudhe dymbëdhjetëmujore llogaritur prej ditës së mbërritjes së notës zyrtare.

3. Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin apo me zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen me dakordësi mes palëve kontraktuese përmes bisedave apo negociatave përkatëse.

Bërë në Tiranë, më 14.7.2023, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS  
FEDERALE TË GJERMANISË



**DEKRET**  
**Nr. 259, datë 29.9.2023**

**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 74/2023, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2022, për projektin ‘Ekonomia qarkulluese për zhvillimin e qëndrueshëm urban në Shqipëri’”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bajram Begaj**

**DEKRET**  
**Nr. 233, datë 25.9.2023**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË  
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Hekuran Dilaver Valteri
2. Anuar Hekuran Valteri
3. Eren Hekuran Valteri
4. Michelle Hekuran Valteri

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bajram Begaj**

**DEKRET**  
**Nr. 234, datë 25.9.2023**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË  
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Altin Xhemal Zharri
2. Klaudio Kujtim Beka
3. Euxhenio Arian Tola
4. Anita Hazbi Koçiaj
5. Jon Gezim Strumi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bajram Begaj**

**DEKRET**  
**Nr. 235, datë 25.9.2023**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË  
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Armando Gori Marku



2. Ledia Piro Ndreu
3. Adrian Luan Mertiraj
4. Vladimir Ramadan Mustafa
5. Ogert Fatmir Dajçi
6. Glauk Ogert Dajçi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bajram Begaj**

**DEKRET**  
**Nr. 236, datë 25.9.2023**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË  
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Ejona Gëzim Gjata
2. Roland Bilal Agalliu
3. Ledia Besim Katroshi
4. Reisi Sinan Memaj
5. Klarisa Reisi Memaj
6. Kevin Reisi Memaj
7. Dorjan Aleksander Lala
8. Sofia Dorjan Lala

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bajram Begaj**

**DEKRET**

**Nr. 237, datë 25.9.2023**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË  
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Loren Bashkim Maska
2. Egi Myslim Basha (Sopoti)
3. Enijada Rremond Sinani
4. Denis Jani Dika
5. Oltjon Skënder Halilaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bajram Begaj**

**DEKRET**  
**Nr. 238, datë 25.9.2023**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË  
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Ani Demir Xhemalaj



2. Ermelinda Zyhdi Kondi (Xheraj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bajram Begaj**

**DEKRET**  
**Nr. 239, datë 25.9.2023**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË  
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Ermal Ferdinand Limaj
2. Holger Avni Hoxha
3. Gestli Gramoz Ismajlisufaj
4. Fatmir Maksut Mara

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bajram Begaj**

**DEKRET**  
**Nr. 240, datë 25.9.2023**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË  
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim

të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

I lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetasës së mëposhtme:  
Marsida Bardhyl Lena (Dylgjeri)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bajram Begaj**

**DEKRET**  
**Nr. 241, datë 25.9.2023**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË  
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

I lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetasës së mëposhtme:  
Blerina Flamur Lile

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bajram Begaj**



**DEKRET**  
**Nr. 242, datë 25.9.2023**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË**  
**SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Xhens Arben Basha
2. Adrian Pandeli Kondi
3. Indrit Xhavit Buci
4. David Indrit Buci
5. Brayan Indrit Buci

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS**  
**SË SHQIPËRISË**  
**Bajram Begaj**

**DEKRET**  
**Nr. 243, datë 25.9.2023**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË**  
**SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Orjeta Albert Lajthija (Gorreja)

2. Ilir Hamit Ahmetaj
3. Altina Ilir Ahmetaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS**  
**SË SHQIPËRISË**  
**Bajram Begaj**

**DEKRET**  
**Nr. 244, datë 25.9.2023**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË**  
**SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, nenit 20, e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Deshire Qamil Muhaxhiri (Bardhi)
2. Ilmije Eshref Rysa (Mataj)
3. Asllan Rufat Kolukaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS**  
**SË SHQIPËRISË**  
**Bajram Begaj**

**DEKRET**  
**Nr. 245, datë 25.9.2023**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË**  
**SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, nenit 20, e në vijim





të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Bislim Muharrem Gashi
2. Shpejtim Man Fanaj

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
Bajram Begaj**

**DEKRET  
Nr. 246, datë 25.9.2023**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË  
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, nenit 20, e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Aziz Azzam Dida
2. Kujtim Mustaf Ukperaj
3. Rrona Azzam Dida
4. Ideal Shukri Gutaj
5. Kadrush Adem Godeni

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
Bajram Begaj**

**DEKRET  
Nr. 247, datë 25.9.2023**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË  
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, nenit 20, e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Malvina Bashkim Islamaj
2. Fadil Muharrem Selimaj
3. Eldin Bashkim Islamaj
4. Korab Mustafa Berisha
5. Beltina Fatmir Feraj
6. Berat Osman Kallabak

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
Bajram Begaj**

**DEKRET  
Nr. 248, datë 27.9.2023**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË  
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, nenit 20, e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:



1. Flamur Fatmir Morina
2. Mine Adem Gashi (Sulaj)
3. Xhevat Mustaf Lala
4. Driton Man Sokoli
5. Ilmaz Fikri Sulaj
6. Hysni Beqë Sokoli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bajram Begaj**

**DEKRET**  
**Nr. 249, datë 27.9.2023**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË  
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, nenit 20, e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Nolita Fatlik Tafarshiku Leti
2. Mirushe Beqë Sogojeva (Sokoli)
3. Eurta Azzam Dida Shporta
4. Fjolla Naser Bedra (Rudi)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bajram Begaj**

**VENDIM**

**Nr. 546, datë 28.9.2023**

**PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Ilir Bejtja, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**

**VENDIM**

**Nr. 547, datë 28.9.2023**

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT  
“STANDARDET SHTETËRORE  
TË GIS-it KOMBËTAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 16, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore të GIS-it kombëtar”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Në GIS-in kombëtar integrohen të dhënat dhe sistemet e informacionit gjeografik të krijuara për temat e nenit 11, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, sipas standardeve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe



autoritetet përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**

## PËRMBAJTJA

### 1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

#### 2. HYRJE

##### 2.1. Qëllimi 2

##### 2.2. Detyrimet ligjore

##### 2.3. Fusha e veprimtimit

3. Të dhënat dhe sistemet që do të përfshihen në GIS-in Kombëtar

#### 4. GIS-i KOMBËTAR

##### 4.1. Moduli i hartës

##### 4.2. Moduli i editimit

##### 4.3. Moduli i metadatës

##### 4.4. Moduli i shërbimeve të rrjetit

##### 4.5. Moduli i arkivimit

##### 4.6. Moduli i konformitetit

##### 4.7. Aneks 1- Shërbimet e rrjetit

##### 4.7.1. Shërbimi i zbulimit

##### 4.7.2. Shërbimi i shikimit

##### 4.7.3. Shërbimi i shkarkimit

##### 4.7.4. Shërbimi i transformimit

### 1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

Ky dokument përmban standardet që duhet të plotësojë informacioni gjeohapësinor për t'u bërë pjesë e GIS-it Kombëtar.

Autori i këtij produkti është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG).

Data e publikimit të versionit nr. 1 është Maj 2023. Emërtimi i dokumentit është ASIG\_Standard\_NSIDI\_2022\_GK\_v.1, ku:

ASIG – autoriteti përgjegjës për krijimin e standardit

Standard – lloji i dokumentit

NSDI – qëllimi i dokumentit

2023 – viti i krijimit

GK – GIS-i Kombëtar

v.1 – numri i versionit të standardit

#### 2. HYRJE

##### 2.1. QËLLIMI

Qëllimi i këtij dokumenti është përcaktimi i specifikimeve teknike, të sistemit Kombëtar të Informacionit Gjeohapësinor (GIS-i Kombëtar), i cili përfshin të dhënat, sistemet tematike të informacionit gjeografik, dhe shërbimet e informacionit gjeografik, që ndërtohen në përputhje me standardet ndërkombëtare të fushës së gjeoinformacionit.

Krijimi i GIS-it Kombëtar është përcaktuar në nenin 16, pika 2, të ligjit nr. 72/2012, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

Ky dokument publikohet si standard që përcakton rregullat bazë të implementimit të NSDI<sup>1</sup>-së në Shqipëri, për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor, që të arrihet një kuptueshmëri unike dhe korrekte e të dhënave dhe e shërbimeve gjeohapësinore, për të realizuar ndërveprueshmërinë midis tyre.

#### 2.2. DETYRIMET LIGJORE

Në bazë të nenit 16, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, ASIG është institucioni përgjegjës për krijimin e standardeve, duke përfshirë edhe standardin e GIS-it Kombëtar, në përputhje me standardet ndërkombëtare të fushës së gjeoinformacionit.

Standardet (Rregullat e Implementimit - IR) do të zbatohen për fushat e mëposhtme:

- Procedura – Përfshirja e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore në GIS-in Kombëtar, do të realizohet sipas rregullave të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 451, datë 3.7.2019, “Për rregullat uniforme të Infrastrukturës së Informacionit Gjeohapësinor”.

- Metadata – Elementet e metadatës së të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore, që do të përfshihen në GIS-in Kombëtar, përcaktohen në rregulloren e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1077, datë 23.12.2015, “Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë”.

- Sistemi referues gjeodezik – Referenca gjeodezike e të dhënave gjeohapësinore, që do të

<sup>1</sup> NSDI - Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Gjeohapësinor.

përfshihen në GIS-in Kombëtar, mbështetet në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 669, datë 7.8.2013, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), si Metadatë”, i ndryshuar.

- Ndërveprueshmëria e të dhënave – Të dhënat dhe shërbimet gjeohapësinore që do të përfshihen në GIS-in Kombëtar, do të jenë në përputhje me rregullat e ndërveprueshmërisë, të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 38, datë 18.1.2017, “Për miratimin e Rregullave të Ndërveprueshmërisë të Dhënave, Grupeve të të Dhënave dhe Shërbimeve Gjeohapësinore”.

- Shkëmbimi i të dhënave – Shkëmbimi i të dhënave, që do të përfshihen në GIS-in Kombëtar,

do të realizohet nëpërmjet shërbimeve të rrjetit, sipas modulit të shtjelluar në këtë dokument, dhe rregullave të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 399, datë 19.6.2019, “Rregullat për Shkëmbimin e Grupeve dhe të Shërbimeve të të Dhënave Gjeohapësinore mes Autoriteteve Publike”.

### 2.3. FUSHA E VEPRIMIT

Të gjitha autoritetet publike, kompanitë private apo individët që mbajnë, përpunojnë apo përditësojnë të dhëna gjeohapësinore për llogari të institucioneve publike, janë të detyruar t'i nënshtrohen këtij standardi.

Bazuar në modelet e proceseve të biznesit, sistemi i propozuar nga direktiva INSPIRE për informacionin gjeohapësinor kalon proceset dhe ciklin jetësor, si më poshtë:




Figura 1: Proceset e ciklit jetësor

“**Ardhja e të dhënës**” është depozitimi i të dhënave nga autoritetet publike përgjegjëse sipas Standardeve Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri. Përditësimi është procesi sipas të cilit autoriteti publik përgjegjës realizon shtimin, modifikimin ose fshirjen e të dhënave gjeohapësinore të cilat janë të publikuara.

“**Kontrolli**” është kontrolli teknik i s të dhënës/shërbimeve të informacionit gjeohapësinor, të vëna në dispozicion nga autoritetet publike përgjegjëse, për miratimin/refuzimin e përfshirjes së tyre në GIS-in Kombëtar.

“**Publikimi**” është procesi me anë të cilit e dhëna e miratuar për përfshirje në GIS-in Kombëtar publikohet në Gjeoportalin Kombëtar.

“**Arkivimi**” është procesi gjatë të cilit grupet e të dhënave, të ardhura nga autoritetet publike përgjegjëse, të cilat kanë një kohëzgjatje të caktuar historike, ruhen për të qenë në dispozicion dhe të aksesueshme nga autoritetet publike.

### 3. TË DHËNAT DHE SISTEMET QË DO TË PËRFSHIHEN NË GIS-IN KOMBËTAR

Të dhënat dhe sistemet e informacionit gjeohapësinor, që do të do të përfshihen në GIS-in



Kombëtar, do të respektojnë kërkesat e këtij standardi, si dhe kërkesat specifike të standardeve tematike, për të gjitha temat e parashikuara sipas pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

Të dhënat do të mblidhen, përpunohen, përditësohen dhe vihen në dispozicion të publikut, në përputhje me standardet e miratuara për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri, për temat e mëposhtme.

1. Përcaktimi i kornizës referuese gjeodezike dhe kontrolli gjeodezik;
2. Sistemet e rrjeteve gjeografike;
3. Emërtimet gjeografike;
4. Imazhi i hartës bazë;
5. Kufijtë e njësive administrative;
6. Sistemi i adresave;
7. Parcelat kadastrale;
8. Rrjetet e transportit;
9. Hidrografia;
10. Zonat e mbrojtura;
11. Modeli digjital i terrenit;
12. Mbulesa e tokës;
13. Ortoimazheria;
14. Gjeologjia;
15. Njësitë statistikore;
16. Ndërtesat;
17. Pedologjia;
18. Përdorimi i tokës;

19. Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij;
20. Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare;
21. Infrastruktura për monitorimin e mjedisit;
22. Infrastruktura industriale;
23. Infrastruktura bujqësore dhe akuakultura;
24. Demografia;
25. Zonat me përdorim të kufizuar;
26. Zonat me rreziqe natyrore;
27. Kushtet atmosferike
28. Meteorologjia;
29. Hidrologjia;
30. Detet;
31. Zonat ekologjike;
32. Habitatet;
33. Shpërndarja e specieve;
34. Burimet energjetike;
35. Burimet minerale.

Specifikimet teknike të të dhënave të standardeve të kësaj kategorie përfshijnë të gjitha atributet e objekteve të ndryshme që do të publikohen. Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri kanë përcaktuar disa attribute bazë, duke u bazuar në direktivën INSPIRE të BE-së, të cilat do të shërbejnë për publikimin e të dhënave të ndryshme. Autoritetet publike përgjegjëse, në zbatim të legjislacionit sektorial ose të nevojave të brendshme, mund të shtojnë attribute të tjera për t’i bërë sa më të përdorshme të dhënat. Të gjitha të dhënat që do të shtohen duhet të jenë të dokumentuara dhe të miratuara nga autoriteti publik përgjegjës.




Figura 2. Skema e përgjithshme për përfshirjen e të dhënave dhe sistemeve në GIS-in Kombëtar



#### 4. GIS-i KOMBËTAR

“GIS-i Kombëtar” është Sistemi Kombëtar i Informacionit Gjeohapësinor, i cili përfshin të gjitha të dhënat dhe sistemet e informacionit gjeografik që ndërtohen për tema të veçanta, në përputhje me standardet e miratuara, që ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe që integrohen nga ASIG-u.

Sistemi i informacionit gjeografik (GIS) është sistemi që mbledh, ruan, analizon, përpunon dhe paraqet të dhëna që lidhen me një fenomen natyror apo shoqëror, gjeoreferencimi i të cilit mundësohet nga një sistem referues koordinativ i përbashkët. Këto sisteme janë një mënyrë teknologjike e të kuptuarit të gjeoinformacionit dhe të marrjes së vendimeve inteligjente. Përdorimi i sistemeve të informacionit gjeografik (GIS) në dekadat e fundit ka marrë një rëndësi gjithnjë e më të madhe. GIS-i gjen përdorim të gjithanshëm në shumë fusha, veçanërisht në krijimin e bazës së të dhënave gjeohapësinore, ku bëhet i mundur menaxhimi i të dhënave gjeohapësinore ndërmjet tematikave të ndryshme.

Autoritetet publike përdorin sistemet e informacionit gjeografik (GIS) për të pasur një menaxhim më të mirë të bazave të të dhënave, por edhe për të vlerësuar rezultatet e politikave që ndërmarrin. Në GIS, autoritetet publike integrojnë lloje të ndryshme të dhënash për të kuptuar, për të funksionalizuar zgjidhjet, për të komunikuar njohuri dhe për të angazhuar palët e interesuara duke përfshirë edhe publikun. Përdorimi i GIS-it përfshin inteligjencën e vendndodhjes në vendimmarrje të nivelit të lartë, ofron njohuri të fuqishme mbi çështjet kritike me të cilat përballet kombi dhe mbështet politikëbërjen e bazuar në shkencë dhe në analizë.

Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) integron pesë komponentë kyç:

- Harduer - përfshin pajisjet fizike mbi të cilat funksionon një Sistem i Informacionit Gjeografik, i cili është i pajisur me një gamë të gjerë të llojeve të infrastrukturës harduareike.

- Softuer - ofron funksione dhe mjete të nevojshme për të ruajtur, analizuar dhe për të shfaqur informacionin gjeohapësinor.

- Informacion gjeohapësinor - janë metadatat, të dhënat dhe grupet e të dhënave gjeohapësinore, që lidhen me një fenomen çfarëdo të realitetit, gjeoreferencimi i të cilit mundësohet nga një sistem hapësinor koordinativ i përbashkët.

- Ekspertët GIS - janë specialistët, teknikët që projektojnë dhe mirëmbajnë sistemin deri tek ata që e përdorin për të kryer punën e tyre në përditshmëri, të cilët merren me menaxhimin dhe zbatimin e planeve për zgjidhjen e problemeve në botën reale.

- Metodologjia – është funksionimi sipas një plani të mirëprojektuar dhe rregullave të cilat janë modele dhe praktika operative unike për çdo autoritet.

Sistemi i GIS-it Kombëtar mundëson ndërveprueshmërinë midis të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore (specifikimet teknike për ndërveprueshmërinë, harmonizimin e grupeve të të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore etj.), bazuar në Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, të miratuara me VKM-të përkatëse.

Krijimi i GIS-it Kombëtar nuk synon vetëm një sistem GIS/TIK që siguron shkëmbimin e gjeoinformacionit ndërmjet institucioneve, por një sistem të nivelit të lartë që përfshin një seri rregullash dhe procedurash administrative, standardesh dhe specifikimesh teknike të detyrueshme për autoritetet publike përgjegjëse. Kjo do të sigurojë që nivelet e ndryshme të përdoruesve (autoritete publike qendrore dhe lokale, sektori privat dhe qytetarët) të kenë informacion të disponueshëm, lehtësisht të aksesueshëm, efektiv, dhe të përditësuar.

Modulet përbërëse të GIS-it Kombëtar janë:

1. Moduli i hartës;
2. Moduli i editimit;
3. Moduli i metadatave;
4. Moduli i shërbimeve të rrjetit;
5. Moduli i arkivimit;
6. Moduli i konformitetit.

##### 4.1. MODULI I HARTËS

Moduli i hartës konsiston në ofrimin e shërbimeve të shikimit për të dhënat gjeohapësinore dhe bën të mundur aksesimin e funksionaliteteve të ndryshme në funksion të të dhënave, për analizimin, përditësimin, dizenjimin, menaxhimin dhe shfaqjen interaktive të informacionit gjeohapësinor.

Funksionalitet bazë që duhet të ofrojë moduli i hartës janë:

1. Identifikimi - ky funksionalitet mundëson identifikimin e objekteve nga të gjitha shtresat e dukshme në hartë.



2. Selektimi i thjeshtë dhe hapësinor i të dhënave gjeohapësinore – ky funksionalitet mundëson të selektoni një objekt në hartë.

3. Marrja e koordinatave në hartë – ky funksionalitet jep mundësinë të marrësh koordinatat e një pike, duke klikuar në hartë dhe zmadhimin me koordinata në një pikë të caktuar në hartë.

4. Matja e gjatësisë dhe sipërfaqes – funksionaliteti i matjes së gjatësive dhe i sipërfaqes në hartë.

5. Vizatimi i një pike, poligoni, pikë me koordinata, vendosja e një shënimi – me këtë funksionalitet mund të vizatoni lloje të ndryshme të objekteve të gjeometrisë në hartë.

6. Lidhja me hartën “Permalink” – ky funksionalitet përdoret për të krijuar lidhjen me pamjen aktuale të hartës, ku mund të kopjohet dhe të ndahet lidhja me kodin QR me përdoruesit e tjerë.

7. Hedhja e një shërbimi të jashtëm – ky funksionalitet mundëson shtimin e shtresave të jashtme WMS/WFS/WMTS në hartë.

8. Kërkimi i avancuar dhe i thjeshtë – ky funksionalitet lejon të specifikoni parametrat e kërkimit të thjeshtë dhe të avancuar.

9. Ngarkimi i një *layer*-i të ri në *Map Viewer* me *drag & drop* – ky funksionalitet mundëson krijimin ose ndryshimin e një shtrese të përkohshme në ambientin e punës së përdoruesve.

10. *Zoom* sipas koordinatave – ky funksionalitet mundëson zmadhimin me koordinata ose të tregoni koordinatat e një pike të caktuar, të zgjedhur.

11. Pamja 3-dimensionale – ky funksionalitet mundëson paraqitjen 3-dimensionale të hartës, e ngjashme me shikimin e hartës në realitet.

12. Mjetet e navigimit – harta përmbledhëse, pamje e plotë, zmadho, zmadho me drejtkëndësh, zvogëlo, pamje e mëparshme, pamja pasardhëse, rrjeti koordinativ etj.

13. Shkarkimi – shkarkimi i të dhënave gjeohapësinore në zonën e kërkuar.

14. Printimi – ky funksionalitet mundëson ruajtjen e një zone të zgjedhur të hartës në formën e një formati PDF, PNG ose JPEG.

15. Gjeoreferimi – funksionaliteti që mundëson ngarkimin dhe gjeoreferencimin e imazheve në hartë.

#### 4.2. MODULI I EDITIMIT

Qëllimi i këtij moduli është të mundësojë një mjedis më shumë përdorues dhe të sigurojë mbështetje për krijimin, editimin dhe shkarkimin e

shtresave. Çdo përdorues nga autoritetet publike do të ketë mundësi të editojë dhe të modifikojë shtresa të përcaktuara. Këto shtresa të përcaktuara do të krijohen dhe do të strukturohen sipas Standardeve Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri. Kjo strukturë do t'i mundësojë editorit të GIS-it Kombëtar të menaxhojë vërtetësinë e të dhënave hyrëse në kohë reale. Për çdo institucion do të ketë një set shtresash të përcaktuara të cilat janë pjesë e Standardeve Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri dhe çdo autoritet publik përgjegjës do të ketë akses të editojë vetëm shtresat që ka në përgjegjësi.

Moduli i editimit do të mbështetet në funksionalitet e modulit të hartës dhe aksesit i tij do të kryhet nëpërmjet regjistrimit të përdoruesve GOV.

Moduli i editimit do të përmbushë nevojat e përdoruesve, autoritete publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore. Ky modul do të lehtësojë detyrat dhe proceset e mirëmbajtjes dhe të menaxhimit të informacionit gjeohapësinor, në mënyrë që të sigurojë ndërveprueshmërinë e grupeve të të dhënave sipas Standardeve Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri.

Funksionalitet bazë që duhet të ofrojë moduli i editimit:

1. Modifikimin e veçorive të gjeometrisë (pikë, vijë, poligon);

2. Funksionalitetin e veçorive të lidhjes së vertekseve gjeometrike ndërmjet tipologjive (pikë, vijë, poligon), *snapping*;

3. Krijimin etributeve të kërkuara për veçoritë e shtuara dhe modifikimin e veçorive ekzistuese me të dhëna të editueshme të shtresave.

4. Krijimin e kodlistave të përcaktuara më parë për fushat etributeve në mënyrë që të lehtësohet shpejtësia e futjes së të dhënave, si dhe krijimin e shtresave me modelin e të dhënave të paracaktuara sipas Standardeve Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri.

5. Zbatimin e rregullave topologjike në krijimin e shtresave.

#### 4.3. MODULI I METADATËS

Moduli i metadatës është një katalog, i cili mundëson informacion të detajuar për të dhënat,



grupet e të dhënave dhe shërbimet gjeohapësinore, që do të përfshihen në GIS-in Kombëtar. Ky modul do të mundësojë zbulimin, inventarizimin dhe përdorimin e të dhënave, grupeve të të dhënave gjeohapësinore, apo shërbimeve që lidhen me to. Metadatat që do të përfshihen në katalog, do të kenë një profil unik dhe do të sigurojnë informacion të detajuar mbi të dhënat, burimet e të dhënave, prejardhjen e tyre etj., për një përdorim sa më efektiv të të dhënave.

Përmbajtja, mënyra e plotësimit, përditësimi dhe mirëmbajtja e metadatës realizohen në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1077, datë 23.12.2015, “Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë”, dhe “Udhëzuesin teknik të detajuar mbi profilin e metadatave për krijuesit dhe përdoruesit”, të hartuar nga ASIG.

#### 4.4. MODULI I SHËRBIMEVE TË RRJETIT

Qëllimi i modulit të shërbimeve të rrjetit është të specifikojë karakteristikat dhe standardet e shërbimeve të rrjetit, që do të aplikohen nga GIS-i Kombëtar dhe sistemet tematike të informacionit gjeografik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, dhe Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, që ka përafuar ky ligj.

Shërbimet e rrjetit që do të ofrojë GIS-i Kombëtar janë:

1. Shërbimi i zbulimit,
2. Shërbimi i shikimit,
3. Shërbimi i shkarkimit,
4. Shërbimi i transformimit.

Shpjegimi i detajuar mbi shërbimet e rrjetit jepet në aneksin 1.

#### 4.5. MODULI I ARKIVIMIT

Qëllimi i këtij moduli ka në fokus arkivimin e të dhënave gjeohapësinore, të ardhura nga autoritetet publike përgjegjëse, që kanë një kohëzgjatje të caktuar historike, të cilat duhen ruajtur për të qenë në dispozicion dhe të aksesueshme nga autoritetet publike.

Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për arkivimin e të dhënave gjeohapësinore ndihmon në

shmangien e rrezikut të humbjes së të dhënave dhe ruajtjen e arkivit me nivele që mbështeten në kopje të shumta, të ruajtura në mënyrë diskrete në sistem. Gjithashtu, sistemi duhet të ofrojë një arkivim automatik të të dhënave gjeohapësinore.

Etapat e krijimit të një mjedisi për ruajtjen e të dhënave janë:

1. Krijimi i një zone arkivimi të fshehtë ku kopjet e të dhënave mund të ruhen dhe të menaxhohen pa u ndryshuar;

2. Krijimi i një hapësire ku të vendoset një kopje e të dhënave, e cila mund të jetë e aksesueshme nga autoritetet publike.

Të dyja (2) mjediset duhet të jenë në sisteme të izoluar ruajtje dhe të dhënat duhet të bëhen *back up*.

Qëllimi kryesor i arkivimit të të dhënave është të sigurojë akses të përshtatshëm dhe afatgjatë të të dhënave. Aksesimi i të dhënave për përdoruesit fundorë mundësohet nëpërmjet internetit dhe funksioneve të kërkimit, në mënyrë që përdoruesit të mund të gjejnë grupet e të dhënave gjeohapësinore që plotësojnë nevojat e tyre. Metadatat e të dhënave dhe grupeve të të dhënave gjeohapësinore, të arkivuara në sistemin e inventarit gjeohapësinor, mundësojnë informacion për përdoruesit mbi grupet e të dhënave gjeohapësinore të arkivuara dhe të zëvendësuar. Sistemi i arkivit duhet të ofrojë mjete ndihmëse për gjetjen e kontekstit të plotë dhe/ose metadatave të arkivuara, për të gjurmuar futjen dhe për të mbështetur ruajtjen e të dhënave. Mjetet ndihmëse dhe metadatat e arkivuara, duhet të ofrojnë një lidhje të drejtpërdrejtë me kontekstin e të dhënave, pavarësisht se ku ruhen, si ruhen apo si emërtohen.

#### 4.6. MODULI I KONFORMITETIT

Autoritetet publike përgjegjëse ngarkojnë të dhënat gjeohapësinore në modulën e konformitetit, fizikisht ose nëpërmjet shërbimeve të rrjetit.

Moduli i konformitetit realizon kontrollin teknik, të të dhënave/sistemeve të informacionit gjeohapësinor, të vëna në dispozicion nga autoritetet publike përgjegjëse për miratimin/refuzimin e përfshirjes së tyre në GIS-in Kombëtar.

Konformiteti do të realizohet për kontrollin e të dhënave dhe shërbimet e rrjetit, të informacionit gjeohapësinor, si më poshtë:



**Kontrolli i konformitetit të të dhënës**

	<b>Kontrolli</b>	<b>Përshkrimi</b>
1	Kontrolli i sistemit koordinativ referencë	Ky proces realizohet duke kontrolluar çdo tipologji ( <i>featureType</i> ) të të dhënave që vijnë nëse e kanë të deklaruar sistemin koordinativ sipas sistemit KRGJSH – ETRS_1989_Albania_2010
2	Kontrolli i katalogut të tipologjive	Kjo fazë konsiston në kontrollin e strukturës së të dhënave gjeohapësinore dhe konformitetit të tyre kundrejt modelit të të dhënave të standardit. Ky kontroll ndahet në dy faza: - Kontrolli i strukturës, emërtimeve dhe numrit të tipologjive ( <i>feature-ve</i> ). - Kontrolli i strukturës, emërtimeve dhe numrit të attributeve të tipologjive.
3	Kontrolli i metadatës	Plotësimi i elementeve të metadatës përcaktohet në rregulloren e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1077, datë 23.12.2015, “Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë”.
4	Kontrolli i cilësisë së të dhënave	Cilësia e të dhënave realizohet dhe deklarohet nga ana e institucionit përkatës që depoziton informacionin gjeohapësinor. Ky kontroll konsiston në cilësinë e të dhënave të elementeve dhe nënelementeve, si dhe cilësinë e matjes së të dhënave, që duhen përdorur për të vlerësuar dhe për të dokumentuar cilësinë e të dhënave për grupet që lidhen me të dhënat gjeohapësinore të secilës temë. Cilësia dhe saktësia e të dhënave deklarohet në metadatën e secilës shtresë.

Kontrolli i së dhënës konsiston në kontrollin e konformitetit të së dhënës siç është shpjeguar në hapat e mësipërm i cili realizohet nga ASIG (konkretisht pika 1, 2 dhe 3), si dhe në kontrollin e cilësisë dhe saktësisë së të dhënës e cila deklarohet në katalogun e metadatës nga autoriteti publik përgjegjës që krijon të dhënën, sipas udhëzuesit teknik të përgatitur nga ASIG-u.

ASIG-u harton dhe miraton udhëzuesin teknik për kontrollin e konformitetit brenda 3 muajve nga miratimi i standardit të GIS-it Kombëtar.

**Kontrolli i konformitetit të shërbimeve të rrjetit**

Bazuar në aneksin 1 të këtij dokumenti (Shërbimet e rrjetit), bëhet kontrolli i të dhënave gjeohapësinore të marra me anë të shërbimeve të rrjetit nga autoriteti publik përgjegjës burim.

Funksionet e Shërbimit të Shikimit janë:

<b>Nr.</b>	<b>Shërbimet e shikimit</b>	<b>Përshkrimi</b>
1	GetMap	Marrja dhe publikimi i të dhënave gjeohapësinore në hartë.
2	GetInfo	Marrja e informacionit mbi shërbimin WMS të publikuar në hartë.
3	GetCapabilities	Marrja e një përshkrimi të detajuar së të dhënës së krijuar me shërbim WMS.
4	Sistemi koordinativ	Sistemi koordinativ dhe gjeometria

**4.7. ANEKS 1 - SHËRBIMET E RRJETIT****4.7.1. SHËRBIMI I ZBULIMIT**

Në mënyrë që të jetë në përputhje me kriteret e kërkimit të përcaktuara në nenin 23, pika 2, të ligjit nr. 72/2012, Shërbimi i Zbulimit do të suportohet tek elementet e metadatave të listuara në tabelën 2 të këtij kreu.

Tabela 2

<b>Kriteret minimale të kërkimit</b>	<b>Elementet e metadatave sipas INSPIRE</b>
Fjalët kyçe ( <i>Keywords</i> )	Fjalët kyçe ( <i>Keywords</i> )
Klasifikimi i të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore (për të dhënat gjeohapësinore dhe grupet e të dhënave gjeohapësinore)	Temat specifike
Klasifikimi i të dhënave dhe shërbimet gjeohapësinore (për shërbimet e të dhënave gjeohapësinore)	Tipi i shërbimeve dhe të dhënave gjeohapësinore



Cilësia dhe vlefshmëria e grupit të të dhënave gjeohapësinore	Rrjedhimet (derivatet)
Cilësia dhe vlefshmëria e grupit të të dhënave gjeohapësinore	Rezultatet gjeohapësinore
Shkalla e përputhshmërisë me rregullat e ndërveprueshmërisë, sipas përcaktimeve të nenit 18 të ligjit nr. 72/2012	Specifikimet
Shkalla e përputhshmërisë me rregullat e ndërveprueshmërisë sipas përcaktimeve të nenit 18 të ligjit nr. 72/2012.	Shkalla e përputhshmërisë
Pozicionimet gjeografike.	Kufijtë gjeografik
Kushtet e aplikimit për aksesin dhe përdorimin e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore	Aplikimi i kushteve për aksesin dhe përdorimin
Kushtet e aplikimit për aksesin dhe përdorimin e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore	Akses i limituar për përdoruesit publik
Autoriteti publik përgjegjës për krijimin, menaxhimin, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore	Palët përgjegjëse
Autoriteti publik përgjegjës për krijimin, menaxhimin, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore	Rolet e palëve përgjegjëse

Elementet ose grupet e elementeve të mëposhtme të metadatave duhet të jenë, gjithashtu, në dispozicion si kriter kërkimi:

1. Titulli i burimit;
2. Abstrakti i burimit;
3. Lloji i burimit;
4. Identifikuesi unik i burimit;
5. Referenca kohore.

Lejon zbulimin e burimit përmes kombinimit të kritereve të kërkimit dhe suportimit të funksioneve logjike dhe të kombinueshme.

Lejon zbulimin e burimeve bazuar në vendndodhjen gjeografike të burimit dhe suportimit të funksioneve gjeohapësinore të listuara në tabelën 3.

Tabela 3

Emri i operatorit	Karakteristikat
Kryqëzimet	Kërkon elementet e metadatave të kufijve gjeografikë të cilët ndërpriten në një zonë të caktuar të interesit.

### 1. LISTA E FUNKSIONEVE

Në mënyrë që të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 23, pika 1/a dhe 2, të ligjit nr. 72/2012, Shërbimi i Zbulimit do të sigurojë funksionet e renditura në tabelën 4 të këtij kreu.

Tabela 4

Funksionet	Rolet
Metadatat për Shërbimin e Zbulimit	Siguron të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me shërbimin dhe përshkruan aftësitë e shërbimit.
Zbulimi i metadatave	Funksioni i zbulimit të metadatave lejon kërkesën e elementeve të metadatave burim, në bazë të një deklaratë që të shikohet nga Shërbimi i Zbulimit.
Publikimi i metadatave	Funksioni i publikimit të metadatave lejon editimin e elementeve burim të metadatave, në Shërbimin e Zbulimit ( <i>push</i> ose <i>pull</i> mekanizmat e metadatave). Editimi nënkupton vendosje, përditësim dhe fshirje.
Linkimi i Shërbimit të Zbulimit	Funksioni i linkimit për Shërbimin e Zbulimit tregon disponueshmërinë e këtij shërbimi për zbulimin e burimeve duke ruajtur burimet e metadatave.

Parametrat kërkesë-përgjigje të çdo funksioni plotësojnë përshkrimin e çdo operacioni dhe formojnë një pjesë integrale të specifikimit teknik të Shërbimit të Zbulimit.



## 2. FUNKSIONET E METADATAVE PËR MARRJEN E SHËRBIMIT TË ZBULIMIT

2.1. Marrja e kërkesës së metadatës për Shërbimin e Zbulimit

2.1.1. Parametrat e kërkesës së metadatave për Shërbimin e Zbulimit. Parametrat e kërkesës së metadatave për Shërbimin e Zbulimi tregojnë gjuhën e zakonshme për përmbajtjen e përgjigjes së Shërbimit të Zbulimit.

2.2. Përgjigja e Metadatave për Shërbimin e Zbulimit

Përgjigja e metadatave për Shërbimin e Zbulimit përmban grupet e mëposhtme të parametrave:

- Metadatat e Shërbimit të Zbulimit;
- Funksionet e metadatave;
- Gjuha e metadatës (në cilën gjuhë zyrtare është e shkruar).

2.2.1. Parametrat e metadatave të Shërbimeve të Zbulimit.

Këta parametra duhet të përmbajnë të paktën elementet e metadatave të Shërbimit të Zbulimit.

2.2.2. Parametrat e funksioneve të metadatave. Parametrat e funksioneve të metadatave japin metadata rreth funksioneve të zbatuara nga Shërbimi i Zbulimit. Këta parametra metadatash do të përshkruajnë secilin funksion si vijon:

1. Të tregojnë për publikimin e metadatave nëse mekanizmi *pull*, *push* ose të dyja janë në dispozicion.

2. Të përshkruajnë çdo funksion, duke përfshirë si minimum një përshkrim të shkëmbimit të të dhënave, si dhe adresën e rrjetit.

2.2.3. Parametrat e gjuhës. Dy parametrat e gjuhës që duhet të sigurohen:

- Parametri i gjuhës së përgjigjes, i cili tregon përdorimin e gjuhës së zakonshme në parametrat e përgjigjes së metadatave për Shërbimin e Zbulimit
- Parametri i suportimit të gjuhës përmban listën e gjuhëve të zakonshme të suportuara nga Shërbimi i Zbulimit

## 3. FUNKSIONI I METADATËS PËR SHËRBIMIN E ZBULIMIT

3.1. Kërkesa e zbulimit të metadatave.

Kjo kërkesë përmban parametrat e mëposhtëm:

- Gjuha;
- Pyetje;

3.1.1. Parametri gjuhë

Parametri gjuhë tregon gjuhën e zakonshme të kërkuar për përmbajtjen e përgjigjes së zbulimit të metadatave.

3.1.2. Parametri pyetje

Parametri pyetje përmban kombinimet e çdo kriteri të specifikuar në paragrafin “Kriteret e kërimit”. Përgjigja e Zbulimit të Metadatave.

3.2 Përgjigja e Zbulimit të Metadatave

3.2.1. Parametrat e përgjigjes së Zbulimit të Metadatave

Parametrat e përgjigjes së Zbulimit të Metadatave duhet të përmbajnë të paktën elementet e metadatave të çdo burimi, që përputhen me kërkesën.

## 4. FUNKSIONI I PUBLIKIMIT TË METADATAVE

Funksioni i publikimit të metadatave mundëson publikimin e burimeve të elementeve të metadatave në Shërbimin e Zbulimit. Dy janë alternativat:

- Mekanizmi *push*, lejon editimin e burimeve të elementeve të metadatave të arritshme nga Shërbimi i Zbulimit.

- Mekanizmi *pull*, lejon Shërbimin e Zbulimit të tërheqë burimet e elementeve të metadatave nga një lokacion në distancë. Së paku një nga alternativat e mësipërme duhet të plotësohet.

4.1. Mekanizmi *push*.

4.1.1. Kërkesa për editimin e metadatave.

4.1.1.1. Parametrat e kërkesës së editimit të metadatave.

Parametri i kërkesës së editimit të metadatave ofron të gjithë informacionet e kërkuara, burimet e elementeve të metadatave të krijuara, përditësuara ose fshirë në Shërbimin e Zbulimit.

4.2. Mekanizmi *pull*

4.2.1. Kërkesë për mbledhjen e metadatave

4.2.1.1. Parametrat e kërkesës për mbledhjen e metadatave.

Parametrat e kërkesës për mbledhjen e metadatave japin të gjitha informatat në lidhje me lokacionet në distancë, të nevojshme për të gjetur burimet e metadatave të vlefshme. Ajo do të përfshihet si një minimum elementesh të metadatave të shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore të dedikuara.

## 5. FUNKSIONI I LINKIMIT PËR SHËRBIMIN E ZBULIMIT

Funksioni i Linkimit për Shërbimin e Zbulimit lejon deklarinimin e disponueshmërinë e një Shërbimi Zbulimi në përputhje me këto rregulla, për zbulimin e burimeve nëpërmjet Shërbimit të Zbulimit të një vendi tjetër duke ruajtur burimet e metadatave të vendit kryesor.



5.1. Kërkesa për Linkimin e Shërbimit të Zbulimit

5.1.1. Parametrat e Linkimit të Shërbimit të Zbulimit

Kërkesa për Linkimin e Shërbimit të Zbulimit do të japë të gjithë informacionin në lidhje me Shërbimin e Zbulimit të autoritetit publik ose palës së tretë, në përputhje me këto rregulla, duke bërë të mundur që Shërbimi i Zbulimit të marrë burimet e metadatave, duke u bazuar në një kombinim të

kritereve të kërkimit nga Shërbimet e Zbulimit të autoritetit publik dhe palës së tretë, dhe t'i mbledhë ato me të tjera burime metadatash.

#### 4.7.2. SHËRBIMI I SHIKIMIT

##### 1. LISTA E FUNKSIONEVE

Në mënyrë që të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 23, pika 1/b dhe pika 2, të ligjit nr. 72/2012, Shërbimi i Shikimit do të sigurojë funksionet e renditura në tabelën 5 të këtij kreu.

Tabela 5

Funksionet	Roli
Marrja e Shërbimit të Shikimit të metadatave	Prodhon të gjithë informacionet e nevojshme rreth shërbimeve dhe përshkrimin të aftësive të shërbimit konkret.
Marrja e hartës ( <i>Get Maps</i> )	Rikthen përmbajtjen e hartës gjeografike dhe informacionin tematik të ardhur nga vlefshmëria e të dhënave gjeohapësinore. Kjo hartë është një imazh referuar gjeohapësirës.
Linku i Shërbimi të Shikimit	Lejon një autoritet publik ose një palë të tretë për të deklaruar një Shërbim Shikimi për shikimin e burimeve të tij, duke ruajtur aftësitë e Shërbimit të Shikimit të lokacionit të autoritetit publik apo palës së tretë.

Parametrat kërkesë-përgjigje të çdo operacioni plotësojnë përshkrimin e çdo operacioni dhe formojnë një pjesë integrale të specifikimit teknik për Shërbimin e Shikimit.

## 2. FUNKSIONI I METADATËS SË MARRJES SË SHËRBIMIT TË SHIKIMIT

2.1. Marrja e kërkesës së metadatave për Shërbimin e Shikimit

2.1.1. Parametrat e marrjes së kërkesave të metadatave për Shërbimin e Shikimit. Parametrat e marrjes së kërkesave të metadatave për Shërbimin e Shikimit tregojnë gjuhën e zakonshme për përmbajtjen e përgjigjes së marrjes së metadatave për Shërbimin e Shikimit.

2.2. Parametrat e përgjigjes së metadatave për marrjen e Shërbimit të Shikimit.

Parametrat e përgjigjes së metadatave për marrjen e Shërbimit të Shikimit do të përmbajnë grupin e mëposhtëm:

- Metadatat e Shërbimit të Shikimit;
- Funksionet e metadatave;
- Gjuha;
- Shtresat e metadatave.

2.2.1. Parametrat e metadatave për Shërbimin e Shikimit

Parametrat e metadatave për Shërbimin e Shikimit duhet të përmbajnë të paktën elementet e metadatave të Shërbimit të Shikimit.

2.2.2. Parametrat e funksioneve të metadatave

Parametrat e funksioneve të metadatave përshkruajnë funksionet e Shërbimit të Shikimit dhe do të përmbajnë si një minimum përshkrimin e të dhënave të shkëmbimit dhe adresën e rrjetit për çdo funksion.

2.2.3. Parametrat e gjuhës

Dy parametrat e gjuhës duhet të sigurojnë:

- Parametri i Gjuhës së Përgjigjes tregon gjuhën e zakonshme të përdorur në parametrat e përgjigjes së metadatave për marrjen e shërbimit.

- Parametri i Gjuhës së Suportimit përmban listën e gjuhëve të zakonshme të suportuar nga Shërbimi i Shikimit.

2.2.4. Parametrat e shtresave të metadatave

Elementet e metadatave të renditura në tabelën 6, do të sigurohen për çdo *Layer*.



Tabela 6

Elementet e metadatave	Përshkrimi
Titulli i burimit	Titulli i <i>Layer-it</i> , përdoret për komunikim njerëzor, për prezantimin e <i>Layer-it</i> , p.sh. në një menu.
Burim abstrakt	<i>Layer</i> abstrakt.
Fjalët kyçe	Shtimi i fjalëve kyçe.
<i>Geographic Bounding Box</i>	Minimumi i kufijve drejtkëndësh mbështetur në Sistemin Koordinativ Referues të zonave të mbulimit nga <i>layer-i</i> .
Identifikuesi unik i burimit	Identifikimi unik i burimit përdoret për të krijuar <i>layer-in</i> .

Parametrat specifikë të *layer-ave* të listuara në tabelën 7, do të sigurohet për çdo *layer*.

Tabela 7

Parametrat	Përshkrimi
Emri	Harmonizimi i emrit të <i>layer-it</i>
Sistemi Referues Koordinativ	Lista e Sistemeve Referuese Koordinative në të cilin <i>layer-i</i> është i vlefshëm.
Llojet	Lista e llojeve të pasqyruara të vlefshme për <i>layer-at</i> . Një lloj përbëhet nga një titull dhe një identifikues unik.
Legjenda URL	Lokacioni i legjendës për çdo lloj, gjuha dhe dimensiononi.
Çift dimensionesh	Tregon suportimin e dy akseve dimensionale për grupe shumëdimensionale të të dhënave apo grupeve të të dhënave gjeohapësinore.

### 3. FUNKSIONI I MARRJES SË HARTËS (*GET MAP*)

#### 3.1. Kërkesa për marrjen e hartës

##### 3.1.1. Parametrat e kërkesës për marrjen e hartës

Parametrat e kërkesës për marrjen e hartës listohen në tabelën 8.

Tabela 8

Parametrat	Përshkrimi
<i>Layer-at</i>	Lista e emërtimeve të shtresave të përfshira në hartë.
Llojet	Lista e llojeve e përdorur për çdo <i>layer</i> .
Sistemi Referues Koordinativ	Sistemi Koordinativ Referues i Hartës.
<i>Bounding box</i>	Katër këndet e hartës dydimensionale për çiftin e dimensioneve dhe selektimin e Sistemit Referues Koordinativ.
Gjerësi e figurës	Gjerësia e hartës në piksel.
Lartësia e figurës	Lartësia e hartës në piksel.
Formati i figurës	Formati <i>output</i> i figurës.
Gjuha	Gjuha e përdorur për përgjigje.
Çifti dimensional	Akset dydimensionale të përdorura për hartën. Për shembull një dimension gjeografik dhe koha.

### 4. FUNKSIONET E LIDHJES SË SHËRBIMIT TË SHIKIMIT

#### 4.1. Kërkesa lidhje e Shërbimit të Shikimit.

##### 4.1.1. Parametrat e kërkesës së lidhjes në Shërbimin e Shikimit.

Parametrat e kërkesës së lidhjes së Shërbimit të Shikimit do të tregojnë të gjithë informacionin në lidhje me Shërbimin e Shikimit të autoritetit publik ose palës së tretë në përputhje me kërkesat e nenit 23, pika 2, e ligjit nr. 72/2012, duke bërë të mundur që Shërbimi i Shikimit të marrë një hartë me Shërbimin e Shikimit të autoritetit publik dhe ta bashkojnë atë me harta të tjera.

### 5. KARAKTERISTIKAT TË TJERA

Shërbimi i Shikimit duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme.

- Sistemi Koordinativ Referues



Parametrat e linkimit të Shërbimit të Shikimit do të stimulohen në të njëjtën kohë, duke përdorur një sistem të vetëm koordinativ referues dhe Shërbimi i Shikimit duhet të suportojë të paktën Sistemin Referues Koordinativ zyrtar.

- Formati i figurës

Shërbimi i Shikimit duhet të suportojë të paktën një nga formatet e mëposhtëm:

- Formati PNG (*Portable Network Graphics*).

- Formati GIF (*the Graphics Interchange Format*), pa kompresim.

#### 4.7.3. SHËRBIMI I SHKARKIMIT

##### 1. LISTA E VEPRIMEVE

Në mënyrë që të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 23, pika 1/c, të ligjit nr. 72/2012, Shërbimi i Shkarkimit duhet të sigurojë funksionet e renditura në Tabelën 9 të këtij kreu.

Tabela 9

Funksionet	Roli
Metadata e shërbimit të shkarkimit ( <i>Get Download Service Metadata</i> ).	Siguron informacionin e nevojshëm në lidhje me shërbimin, grupet e të dhënave gjeohapësinore të vëna në dispozicion, dhe përshkruan aftësitë e shërbimit.
Marrja e të dhënave gjeohapësinore ( <i>Get Spatial Data Set</i> ).	Lejon tërheqjen e grupit të të dhënave gjeohapësinore.
Përshkrimi i të dhënave gjeohapësinore ( <i>Describe Spatial Data Set</i> ).	Ky operacion kthen si përgjigje përshkrimin e të gjitha llojeve të objekteve gjeohapësinore të përfshira në grupin e të dhënave gjeohapësinore.
Linkimi i shërbimit të shkarkimit.	I jep të drejtën, një autoriteti publik ose një pale të tretë, mbi Shërbimin e Shkarkimit për të shkarkuar të dhënat ose grupet e të dhënave gjeohapësinore, aty ku është e praktikueshme. Shkarkon shërbimin, duke ruajtur aftësinë e shkarkimit në vendndodhjen e autoritetit publik apo palës së tretë përgjegjëse.

Parametrat kërkesë-përgjigje të çdo operacioni plotësojnë përshkrimin e çdo funksioni dhe formojnë një pjesë integrale të specifikimeve teknike të Shërbimit të Shkarkimit.

## 2. FUNKSIONI I METADATAVE TË SHËRBIMIT TË SHKARKIMIT (*GET DOWNLOAD SERVICE METADATA*)

2.1. Kërkesa për marrjen e të dhënave gjeohapësinore (*Get Spatial Data Set*)

2.1.1 Përshkrimi i të dhënave gjeohapësinore (*Describe Spatial Data Set*)

Parametrat e kërkesës së Shërbimit të Shkarkimit për metadatat tregojnë gjuhën e zakonshme që do të përdoret për përmbajtjen e përgjigjes për Shërbimin e Shkarkimit të metadatave.

2.2. Funksioni i marrjes së përgjigjes për metadatat e shërbimit të shkarkimit.

Funksioni përgjigje për metadatat e Shërbimit të Shkarkimit përmban grupet e mëposhtme të parametrave:

- Metadatat e shkarkimit;
- Funksionet e metadatave;
- Gjuha;
- Metadatat e të dhënave gjeohapësinore.

2.2.1 Parametrat e metadatave për Shërbimin e Shkarkimit.

Parametrat e Shërbimit të Shkarkimit të metadatave duhet të përmbajnë elementet e metadatave të shërbimeve, sipas VKM-së nr. 1077, datë 23.12.2015.

2.2.2 Parametrat e funksioneve të metadatave.

Parametrat e funksioneve të metadatave japin metadata rreth zbatimit të funksioneve të Shërbimit të Shkarkimit. Ato duhet të japin të paktën një përshkrim të çdo funksioni, duke përfshirë shkëmbimin e të dhënave dhe adresën e rrjetit.

2.2.3 Parametrat e gjuhës

Sigurohen dy parametra gjuhe:

- Parametrat e gjuhës së përgjigjes tregojnë gjuhën e zakonshme që përdoret në parametrat e përgjigjes së metadatave të Shërbimit të Shkarkimit.

- Parametrat e gjuhës së suportimit përmbajnë listën e gjuhëve të zakonshme, mbështetur nga Shërbimi i Shkarkimit.

2.2.4 Parametrat e metadatave për grupin e të dhënave

Elementet e metadatave të grupit të të dhënave gjeohapësinore, të vëna në dispozicion, duhet të



parashikohen. Përveç kësaj, për çdo grup të dhënash gjeohapësinore, duhet të parashikohen lista e Sistemeve Koordinative të Referimit, të vlefshme sipas rregullave të ndërveprueshmërisë.

### 3. VEPRIMET E MARRJES SË GRUPIT TË TË DHËNAVE GJEOHAPËSINORE

#### 3.1 Kërkesa për marrjen e një grupi të dhënash gjeohapësinore

Kërkesa për marrjen e një grup të dhënash gjeohapësinore përmban parametrat e mëposhtëm:

- Gjuhën;
- Identifikimin e të dhënave gjeohapësinore;
- Sistemin Koordinativ Referues.

##### 3.1.1. Parametrat e gjuhës

Në parametrin gjuhë shënohet gjuha natyrore e të dhënave gjeohapësinore.

##### 3.1.2. Parametrat Identifikues të të Dhënave Gjeohapësinore.

Identifikimi i parametrave të të dhënave gjeohapësinore duhet të përmbajë identifikues unik të këtyre burimeve gjeohapësinore.

##### 3.1.3. Parametrat e Sistemit Referues Koordinativ

Parametrat e Sistemit Koordinativ duhet të përmbajnë një nga Sistemet Koordinativ Referues të përfshira në listën e disponueshme të këtyre sistemeve të parashikuara në pikën 2.2.4.

#### 3.2. Përgjigja e të dhënave gjeohapësinore

##### 3.2.1. Parametrat e përgjigjes së të dhënave gjeohapësinore

Parametrat e të dhënave gjeohapësinore duhet të jenë të paraqitura në gjuhën dhe në Sistemin Koordinativ Referues të kërkuar.

### 4. PËRSHKRIMI I VEPRIMEVE TË TË DHËNAVE GJEOHAPËSINORE

#### 4.1 Përshkrimi kërkesës së të dhënave gjeohapësinore

Përshkrimi kërkesës së të dhënave gjeohapësinore përmban parametrat e mëposhtëm:

- Gjuhën;
- Identifikimin e grupit të të dhënave gjeohapësinore;

##### 4.1.1. Parametrat e gjuhës.

Parametrat gjuhësorë tregojnë gjuhën e zakonshme të kërkesës për përshkrimin e tipit të objekteve gjeohapësinore.

##### 4.1.2. Parametrat e identifikimit të të dhënave gjeohapësinore

Parametrat identifikues të të dhënave gjeohapësinore do të përmbajnë burim identifikues unik të të dhënave gjeohapësinore.

#### 4.2. Përshkrimi i përgjigjes së të dhënave gjeohapësinore

##### 4.2.1. Parametrat e përshkrimit të përgjigjes së të dhënave gjeohapësinore

Parametrat e përshkrimit të përgjigjes së të dhënave gjeohapësinore duhet të jenë përshkrimi i kërkesës së objekteve dhe të dhënave gjeohapësinore në gjuhën e kërkuar.

### 5. FUNKSIONI I LINKIMIT TË SHËRBIMIT TË SHKARKIMIT

Funksioni i linkimit të Shërbimit të Shkarkimit nënkupton disponueshmërinë e Shërbimit të Shkarkimit, në përputhje me këto rregulla, për shkarkimin nga burime të ndryshme nga ai i vendit të burimit kryesor.

#### 5.1. Kërkesa për Linkimin e Shërbimit të Shkarkimit

##### 5.1.1. Parametrat e kërkesës për Linkimin e Shërbimit të Shkarkimit

Parametrat e kërkesës për linkimin e Shërbimit të Shkarkimit duhet të përmbajnë të gjithë informacionin rreth Shërbimit të Shkarkimit të autoritetit publik ose palës së tretë përgjegjëse, në përputhje me këto rregulla.

Aksesimi direkt i funksioneve të shkarkimit.

### 6. LISTA E FUNKSIONEVE.

Kur Shërbimi i Shkarkimit jep akses të drejtpërdrejtë të grupeve të të dhënave gjeohapësinore, ai do të ofrojë, përveç funksioneve të renditura në tabelën 11, dhe funksionet e renditura në tabelën 10 të këtij kreu.

Tabela 10

Funksionet	Rolet
Marrja e objekteve gjeohapësinore ( <i>Get Spatial Object</i> ).	Ky funksion lejon rikthimin e objekteve gjeohapësinore bazuar mbi një kërkesë.
Tipi i përshkrimit të objekteve gjeohapësinore ( <i>Describe Spatial Object Type</i> )	Ky funksion rikthen përshkrimin e tipit specifik të objektit gjeohapësinor.



## 7. FUNKSIONI I MARRJES SË OBJEKTEVE GJEOHAPËSINORE

7.1. Kërkesa për marrje të objekteve gjeohapësinore

Kërkesa për marrje të objekteve gjeohapësinore ka parametrat e mëposhtëm:

- Gjuha;
- Identifikimi i të Dhënave Gjeohapësinore;
- Sistemi Referues Koordinativ;
- Kërkesa.

### 7.1.1 Parametrat gjuhësorë

Parametrat gjuhësorë tregojnë gjuhën e zakonshme të kërkuar për objektet gjeohapësinore.

7.1.2. Identifikimi i parametrave të grupit të të dhënave gjeohapësinore.

Identifikimi i parametrave të grupit të të dhënave gjeohapësinore duhet të përmbajë identifikues unikë të burimeve të të dhënave gjeohapësinore. Kur parametrat nuk janë dhënë, do të supozohet se janë përzgjedhur të gjitha të dhënat gjeohapësinore të vëna në dispozicion.

7.1.3. Parametrat e Sistemit Koordinativ Referues

Sistemi Koordinativ Referues duhet të përmbajë një nga Sistemet Koordinative Referues të përfshirë në listën e Sistemeve Koordinativ Referues të përcaktuara në rregullat e ndërveprueshmërisë.

### 7.1.4. Parametrat e pyetjes

Parametrat e pyetjes do të përbëhen nga kriteret e kërimit të renditura në pikën 9.

7.2. Përgjigjja e një grupi të dhënash gjeohapësinore.

Përgjigjja e një grupi të dhënash gjeohapësinore do të përmbajë parametrat e mëposhtme:

- Vendosja e objekteve gjeohapësinore;
- Metadatave të objekteve gjeohapësinore.

7.2.1. Parametrat e një grupi objektsh gjeohapësinore

Parametrat e një grupi objektsh gjeohapësinore – Së pari duhet të jetë grup i objekteve gjeohapësinore që është në përputhje me rregullat e ndërveprueshmërisë dhe plotëson kriteret e kërimit sipas kërkesës, në gjuhën e kërkuar dhe në Sistemin Koordinativ Referues.

7.2.2. Parametrat e Metadatave të Objektet Gjeohapësinore

Parametrat e metadatave të objekteve gjeohapësinore duhet të përmbajnë të paktën elementet e metadatave të objekteve gjeohapësinore.

## 8. FUNKSIONET E PËRSHKRIMIT TË TIPIT TË OBJEKTIT GJEOHAPËSINOR

8.1. Përshkrimi i tipit të kërkesës së objekteve gjeohapësinore. Përshkrimi i tipit të kërkesës së objekteve gjeohapësinore përmban parametrat e mëposhtëm:

- Gjuha;
- Tipi i objektit gjeohapësinor.

### 8.1.1. Parametri gjuhë

Parametri gjuhë, duhet të tregojë gjuhën e zakonshme të kërkuar për përshkrimin e tipit të objektit gjeohapësinor.

### 8.1.2. Parametrat e tipit të objektit gjeohapësinor

Parametrat e tipit të objektit gjeohapësinor duhet të përmbajnë emrin e gjuhës së zakonshme të tipit të objektit gjeohapësinor, siç është specifikuar në rregullat e ndërveprueshmërisë. Kur parametri nuk është dhënë, do të supozohet që të gjitha llojet e objekteve gjeohapësinore janë përzgjedhur.

8.2. Përshkrimi i përgjigjes së tipit të objektit gjeohapësinor

8.2.1. Përshkrimi i parametrave të përgjigjes së objektit gjeohapësinor

Parametrat e përgjigjes së objektit gjeohapësinor është përshkrimi i llojit të objektit gjeohapësinor në përputhje me rregullat e ndërveprueshmërisë.

## 9. KRITERET E KËRKIMIT PËR MARRJEN E FUNKSIONEVE TË OBJEKTEVE GJEOHAPËSINORE

Për shkak të veprimeve të grupit të të dhënave gjeohapësinore për Shërbimin e Shkarkimit, do të implementohen kriteret e mëposhtme të kërimit:

- Identifikimi unik i burimeve të të dhënave gjeohapësinore;

- Të gjitha atributet identifikuese të përshtatshme dhe marrëdhëniet midis objekteve gjeohapësinore të përcaktuara në bazë të rregullave të ndërveprueshmërisë, në veçanti Identifikuesi Unik i Objektit Gjeohapësinor dhe karakteristikat e dimensioneve kohore, duke përfshirë datën e përditësimit.

- *Bounding box* e shprehur në ndonjë nga Sistemet Koordinative Referuese të njohura, sipas rregullave të ndërveprueshmërisë.

- Tema e të dhënave gjeohapësinore. Për zbulimin e objekteve gjeohapësinore përmes një kombinimi të kriterëve e kërimit, do të suportohet nga operatorët logjikë dhe krahasues.





#### 4.7.4. SHËRBIMI I TRANSFORMIMIT

##### 1. LISTA E FUNKSIONEVE

Në mënyrë që të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 23, pika 1/ç, të ligjit nr. 72/2012, Shërbimi i Transformimit do të ofrojë funksionet e renditura në tabelën 11 të këtij kreu.

Tabela 11

Funksionet	Roli
Metadatat për marrjen e Shërbimit të Transformimit	Siguron të gjithë informacionin e nevojshëm mbi shërbimin dhe përshkruan veçoritë e shërbimit, duke përfshirë edhe kategorinë e transformimit, suportet e transformimit, tipat e të dhënave input të pranuar, definimin e modelit të suportuar dhe gjuhën e hartës.
Transformimi	Kryen procesin aktual të transformimit.
Linkimi i Shërbimit të Transformimit	Lejon disponueshmërinë e Shërbimit të Transformimit për transformimin e grupit të të dhënave gjeohapësinore nëpërmjet Shërbimit të Transformimit të një autoriteti tjetër, duke ruajtur aftësinë e transformimit nga vendndodhja e autoritetit publik apo palës së tretë.

Parametrat kërkesë-përgjigje të çdo funksioni plotësojnë përshkrimin e çdo funksioni dhe formojnë një pjesë integrale të specifikimeve teknike të Shërbimit të Transformimit.

##### 2. FUNKSIONI I METADATAVE PËR MARRJEN E SHËRBIMIT TË TRANSFORMIMIT

###### 2.1. Kërkesa e metadatave për marrjen e Shërbimit të Transformimit

###### 2.1.1. Parametrat e kërkesës së metadatave për marrjen e Shërbimit të Transformimit

Parametrat e kërkesës së metadatave për marrjen e Shërbimit të Transformimit tregojnë gjuhën e zakonshme për përmbajtjen e kërkesës së metadatave për marrjen e Shërbimit të Transformimit.

###### 2.2. Përgjigja e metadatave për marrjen e Shërbimit të Transformimit

Përgjigja e metadatave për marrjen e Shërbimit të Transformimit përmbajnë grupet e mëposhtme të parametrave:

- Metadatat e Shërbimit të Transformimit;
- Funksionet e metadatave;
- Gjuhën.

###### 2.2.1. Parametrat e metadatave për Shërbimin e Transformimit

Parametrat e metadatave për Shërbimin e Transformimit duhet të përmbajnë të paktën elementet e metadatës të Shërbimit të Transformimit.

###### 2.2.2. Parametrat e funksioneve të metadatave

Parametrat e funksioneve të metadatave japin metadatat rreth funksioneve të zbatuara nga Shërbimi i Transformimit.

Ato do të përshkruajnë çdo funksion, duke përfshirë si një minimum, përshkrimin e shkëmbimit të të dhënave dhe adresën e rrjetit, të listuara si më poshtë:

- Kategoritë e transformimit të miratuara nga funksioni i transformimit;
- Dekodimin për vendosjen e inputeve të të dhënave gjeohapësinore të miratuara nga funksioni i transformimit;
- Modeli i gjuhës së të dhënave miratuara nga funksioni i transformimit;
- Modeli i gjuhës së hartës miratuar nga funksioni i transformimit;

###### 2.2.3. Parametrat e gjuhës

Dy parametra duhet të sigurohen:

- Parametri i gjuhës së përgjigjes tregon gjuhën e zakonshme të përdorur në përgjigjen e metadatës për marrjen e Shërbimit të Transformimit;
- Parametrat e gjuhës të suportuar përmban listën e gjuhëve të zakonshme mbështetur nga Shërbimi i Transformimit.

##### 3. FUNKSIONI I TRANSFORMIMIT

###### 3.1. Kërkesa për transformim

Kërkesa për transformim përmban parametrat e mëposhtëm:

- Input i të dhënave gjeohapësinore;
- Modeli i burimit;
- Model i targetit;
- Model i hartëzimit.



3.1.1. Parametrat input të të dhënave gjeohapësinore

Parametrat input të të dhënave gjeohapësinore duhet të tregojnë të dhënat gjeohapësinore për t'u transformuar.

3.1.2. Parametri i modelit të burimit

Parametri i modelit të burimit do të specifikojë modelin input të të dhënave gjeohapësinore.

3.1.3. Parametri i modelit të targetit

Parametri i modelit të targetit duhet të specifikojë modelin në të cilin inputi i të dhënave gjeohapësinore do të transformohet.

3.1.4. Parametri i modelit të hartëzimit

Parametër i modelit të hartëzimit duhet të specifikojë hartën nga modeli burim në modelin target.

3.2. Përgjigje e transformimit

3.2.1. Parametrat e përgjigjes së transformimit.

Parametrat e përgjigjes së transformimit duhet të përmbajnë të dhënat gjeohapësinore të transformuara në përputhje me rregullat e ndërveprueshmërisë.

#### 4. FUNKSIONI I LINKIMIT TË SHËRBIMIT TË TRANSFORMIMIT

4.1. Linkimi i kërkesës së Shërbimit të Transformimit

4.1.1. Parametrat e linkimit të kërkesës së Shërbimit të Transformimit

Parametrat e linkimit të kërkesës së Shërbimit të Transformimit duhet t'u sigurojnë të gjitha informacionet në lidhje me Shërbimin e Transformimit autoriteteve publik apo palëve të treta në përputhje me këto rregulla, duke bërë të mundur përdorimin e Shërbimit të Transformimit prej tyre.

### VENDIM

Nr. 548, datë 28.9.2023

#### **PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 6.7.2023, PËR ÇËSHTJEN “ELGAKOTI SHPK DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË” (PËR KËRKESËN NR. 63986/10 DHE 5 KËRKESA TË TJERA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për

ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

### VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 6.7.2023, për çështjen “Elgakoti sh.p.k. dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për kërkesat nr. 63986/10 (Elgakoti sh.p.k.), nr. 11487/11 (Carcu), nr. 48963/11 (Shkëmbi), nr. 45719/12 (Kulo), nr. 45720/12 (Brovina) dhe nr. 71642/12 (Gjata), sipas shumave të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat e përcaktuara si detyrim në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi, të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku depozitohet shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi, të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkuesve, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 6.7.2023, “Elgakoti sh.p.k. dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 63986/10 dhe 5 kërkesa të tjera, për secilën kërkesë.

4. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të kërkuesve, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, bëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi, të paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin marginal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus 3%.

6. Efektet financiare, të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2023.



7. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

**Belinda Balluku**

SHTOJCA 1. LISTA E KËRKUESVE DHE SHPËRBLIMI I DREJTË

Nr.	Numri i kërkesës	Kërkesit	Dëmi jopasuror	Kostot dhe shpenzimet <sup>2</sup>
1	63986/10	Elgakoti sh.p.k.	2 500 euro	
2	11487/11	Arben Carciu	3 600 euro	250 euro
3	48963/11	Edipe Shkëmbi	4 700 euro	
4	45719/12	Harallamb Kulo  zëvendësuar nga trashëgimtarët: Ermioni Kulo Anila Kulo Elina Kulo	3 600 euro	
5	45720/12	Fisnik Brovina	4 700 euro	
6	71642/12	Sotirag Gjata	4 700 euro	

**VENDIM**

**Nr. 549, datë 28.9.2023**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “PROJEKT I PARKUT UJOR TUSHEMISHT – DRILON, BASHKIA POGRADEC”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Projekt i Parkut Ujor Tushemisht – Drilon, Bashkia Pogradec”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Pogradec.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, “arë” dhe “ledh”, me një vlerë të përgjithshme prej 5 233 990 (pesë milionë e dyqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 5 233 990 (pesë milionë e dyqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Pogradec.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi

<sup>2</sup> Plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme mbi kostot dhe shpenzimet.



të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Pogradec.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Pogradec për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Pogradec për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Pogradec, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**



LISTA E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE E TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “PROJEKT I PARKUT UJOR TUSHEMISHT – DRILON”, BASHKIA POGRADEC

NR.	PRONARI	TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)									VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM						SHËNIME (Kufizime hipotekore, barër mbi pasuritë etj.)				
		Emri Atesia Mbiemri	P.shitose qytet	Z. Kadastrale	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Aer (m <sup>2</sup> )	Tundë (m <sup>2</sup> )	Volumi	Fisaje	ARE		TRUALL				PA FRUTE (LIVADH, KULLOTA)			VLERA TOTALE (lekë)
												Sipërfaqja (m <sup>2</sup> )	Çmimi (lekë/m <sup>2</sup> )	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> )	Çmimi (lekë/m <sup>2</sup> )	Vlera (lekë)		Sipërfaqja (m <sup>2</sup> )	Çmimi (lekë/m <sup>2</sup> )	Vlera (lekë)	
1	ALBERT NEKI CAKE	Gurras	1903	51/34	arë	427				1	126	427	192	81984						81984	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	NEKI DILAVER CAKE	Gurras	1903	51/35	arë	1450				1	127	1450	192	278400						278400	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	MIHAL BEKHET CAKE	Gurras	1903	51/36	arë	823				1	162	192	192	36864						36864	Konfirmuar nga ASHK-ja
4	AVDULLA VAFI CAKE ISMETE RAMADAN CAKE ERIN AVDULLA CAKE EDUART AVDULLA CAKE	Gurras	1903	51/78	arë	2240				9	69	157	192	30144						30144	Konfirmuar nga ASHK-ja
5	EDUART ZOTO	Gurras	1903	49/2/1	arë	1460				3	36	283	192	54336						54336	Konfirmuar nga ASHK-ja
6	SEFEDIN ISTREF HOXHA	Gurras	1903	49/2/2	arë	972				1	232	211	192	40512						40512	Konfirmuar nga ASHK-ja
7	TUFE QAMIL BEQIRI	Gurras	1903	49/2/3	arë	1540				4	144	347	192	66624						66624	Konfirmuar nga ASHK-ja
8	CELNIK KADRI BEGA GJENTAN KADRI BEGA NAZIF BEGA	Gurras	1903	49/2/53	arë	1197				9	1163	271	192	52032						52032	Konfirmuar nga ASHK-ja
9	NIKO ZEQQ BEGA SHQIPE ZEQQ BEGA	Gurras	1903	49/2/5	arë	534				4	174	173	192	33216						33216	Konfirmuar nga ASHK-ja
10	PAQESOR ZEQQ BEGA	Gurras	1903	49/2/6	arë	2919				4	175	614	192	117888						117888	Konfirmuar nga ASHK-ja
11	SHQIPE ZEQQ RIKA ERGYS JANI RIKA FLAMUR JANI RIKA	Gurras	1903	49/2/7	arë	1922				3	85	513	192	98496						98496	Konfirmuar nga ASHK-ja
12	MARIA ISLAM BEQIRI ALTIN HASAN BEQIRI	Gurras	1903	49/2/44	arë	1697				8	226	353	192	67776						67776	Konfirmuar nga ASHK-ja
13	MISR ABIDIN BEQIRI	Gurras	1903	49/2/9	arë	526				4	147	172	192	33024						33024	Konfirmuar nga ASHK-ja
14	KURTI RAMIZ MAXHARI	Gurras	1903	49/2/10	arë	2035				3	222	702	192	134784						134784	Konfirmuar nga ASHK-ja
15	ISMAIL RAMIZ MAXHARI	Gurras	1903	49/2/11	arë	1825				3	226	335	192	64320						64320	Konfirmuar nga ASHK-ja
16	RAMAZAN HYAMERI ISPAHO	Gurras	1903	49/2/12	arë	2760				2	40	724	192	139088						139088	Konfirmuar nga ASHK-ja
17	GEJTM SELAMI ABESH	Gurras	1903	49/2/13	arë	2760				2	38	617	192	118464						118464	Konfirmuar nga ASHK-ja
18	RAFET FEJZI CAKE	Gurras	1903	49/2/14	arë	2480				1	46	548	192	105216						105216	Konfirmuar nga ASHK-ja
19	ANDON AMIT ABRASHI	Gurras	1903	49/2/15	arë	1380				4	21	383	192	73536						73536	Konfirmuar nga ASHK-ja
20	AKSLAN AMIT ABRASHI	Gurras	1903	49/2/16	arë	2475				4	48	447	192	88824						88824	Konfirmuar nga ASHK-ja
21	JULLIAN BUJAR CAKE	Gurras	1903	49/2/35	arë	1700				9	199	212	192	40704						40704	Konfirmuar nga ASHK-ja
22	JULLIAN BUJAR CAKE	Gurras	1903	49/2/36	arë	274				9	200	228	192	43776						43776	Konfirmuar nga ASHK-ja
23	HYSEN MYSLIM TOPALLI ILIRIAN EMIRI GINARI IRENA EMIRI DUDA ANEZA EMIRI BALLE	Gurras	1903	49/2/47	arë	1966				9	89	502	192	96384						96384	Konfirmuar nga ASHK-ja
24	BUJAR VAFI BOCI	Gurras	1903	49/2/20	arë	405				3	140	87	192	16704						16704	Konfirmuar nga ASHK-ja
25	FATMIR CAKE	Gurras	1903	49/2/21	arë	2712				1	4	332	192	63744						63744	Konfirmuar nga ASHK-ja
26	SHABAN MEHMETI VEJRI LLARI	Gurras	1903	49/2/59	arë	942				10	209	65	192	12480						12480	Konfirmuar nga ASHK-ja
27	RAFET MEHDI CAKE MYQHREME SAMI CAKE	Gurras	1903	49/2/42	arë	360				8	131	56	192	10752						10752	Konfirmuar nga ASHK-ja
28	MELEQ MEHDI CAKE	Gurras	1903	49/2/43	arë	1710				8	132	181	192	34752						34752	Konfirmuar nga ASHK-ja
29	FEIM XHEMAL RISHO	Gurras	1903	49/2/24	arë	1145				3	171	95	192	18240						18240	Konfirmuar nga ASHK-ja
30	RAMAZAN FERIT LILO	Gurras	1903	49/2/25	arë	200				1	174	28	192	5376						5376	Konfirmuar nga ASHK-ja
31	JULLIAN BUJAR CAKE	Gurras	1903	49/2/26	arë	1126				1	64	37	192	7104						7104	Konfirmuar nga ASHK-ja
32	LAVDERIM KADRI CAKE	Gurras	1903	49/2/27	arë	2905				6	186	61	192	11712						11712	Konfirmuar nga ASHK-ja
33	FUAT NEFAT CANO	Gurras	1903	49/1/12	arë	954				3	92	41	192	7872						7872	Konfirmuar nga ASHK-ja
34	RUSHIT HAJDAR CELA	Gurras	1903	49/1/11	arë	896				4	1	254	192	48768						48768	Konfirmuar nga ASHK-ja
35	MUHAMER HASAN BALLIU	Gurras	1903	49/1/10	arë	539				4	170	165	192	31680						31680	Konfirmuar nga ASHK-ja
36	MUHAMER HASAN BALLIU	Gurras	1903	49/1/9	arë	150				4	160	59	192	11328						11328	Konfirmuar nga ASHK-ja
37	MUHAMER HASAN BALLIU	Gurras	1903	49/1/8	arë	1859				3	30	555	192	106560						106560	Konfirmuar nga ASHK-ja
38	MUHARREM HASAN BALLIU	Gurras	1903	49/1/7	arë	990				4	163	297	192	57024						57024	Konfirmuar nga ASHK-ja
39	SEMIN SHULLI CAKE	Gurras	1903	49/1/16	arë	2970				1	53	875	192	168000						168000	Konfirmuar nga ASHK-ja
40	SEMIN LYTI CAKE	Gurras	1903	112/4	trual	300			300	5	161				19	1640		31160		31160	Konfirmuar nga ASHK-ja
41	AQIF QANI CAKE BESSNIK ISMAIL SHULI	Gurras	1903	112/3	trual	342			342	4	217				10	1640		16400		16400	Konfirmuar nga ASHK-ja
42	ILIRIAN ISMAIL SHULI ADRIATIK ISMAIL SHULI NIKO ISMAIL SHULI	Gurras	1903	54/6	arë	1242				4	87	28	192	5376						5376	Konfirmuar nga ASHK-ja
43	GJERGJI KOLI POCE ANETA BERTI SHUKE LINDA BERTI LANI ERJON SOTIRAQ POCE NIKOLIN SOTIRAQ POCE GJHOLA SOTIRAQ VAKO KRISTINA KOPI SPIRO LLARI VASILKA KOPI MITRA DHIMITRA KOPI PILANCI	Tushemisht	3664	48/3	arë	1500				4	189	1500	192	288000						288000	Konfirmuar nga ASHK-ja



	DIANA SANDRI GACE VIOLLA SANDRI ANGIO LEONORA MITRI ANGHJELLARI ERALDA NESTI ANGHJELLARI ARMAND NESTI ANGHJELLARI IRIDA NESTI ANGHJELLARI																		
44	DHIMITRI MIHAL BARDHI	Tushemishi	3664	44/1	arë	1430		2	219	440	192	84480					84480	Konfirmuar nga ASHK-ja	
45	GJERGJI KOPI PILINXHI MARIJANA KOPI LEKA DRITAN ALI TASELLARI LEONARD PIRO TASELLARI FERDINAND PIRO TASELLARI DIANA PIRO TASELLARI ILIR PIRO TASELLARI	Tushemishi	3664	49/3	ledh	2300		4	60					1014	83	84162	84162	Konfirmuar nga ASHK-ja	
46	GJERGJI KOPI PILINXHI MARIJANA KOPI LEKA DRITA ALI TASELLARI LEONARD PIRO TASELLARI FERDINAND PIRO TASELLARI DIANA PIRO TASELLARI ILIR PIRO TASELLARI	Tushemishi	3664	49/1	ledh	2700		4	58					2700	83	224100	224100	Konfirmuar nga ASHK-ja	
47	*Res-Ho L&C*shpk	Tushemishi	3664	4/83	truall	600		6	81			27	1640			44280	44280	Konfirmuar nga ASHK-ja	
48	DHIMITER PIRO MIHILLI VASHI PIRO MIHILLI	Tushemishi	3664	4/57	truall	320		4	102			276	1640			452640	452640	Konfirmuar nga ASHK-ja. Rivlerësohet pasuria me ref. 0578, datë 29.7.2012 në shumën 476000	
49	DHIMITER PIRO MIHILLI VASHI PIRO MIHILLI	Tushemishi	3664	46/4	truall	888		4	105			744	1640			1220160	1220160	Konfirmuar nga ASHK-ja	
50	KRISTIAQ MITLLARI	Tushemishi	3664	4/88	arë	750		6	179	209	192	40128					40128	Konfirmuar nga ASHK-ja	
51	GJERGJI KOLI POCE ANETA BERTI SHUKE LINDA BERTI LANI ERION SOTIRAQ POCE NIKOLIN SOTIRAQ POCE GHOLA SOTIRAQ YAKO KRISTINA KOPI SPIKOLLARI VASILIKA KOPI MITKA DHIMITRA KOPI PILINCI DIANA SANDRI GACE VIOLLA SANDRI ANGIO LEONORA MITRI ANGHJELLARI ERALDA NESTI ANGHJELLARI ARMAND NESTI ANGHJELLARI IRIDA NESTI ANGHJELLARI	Tushemishi	3664	50/3	arë	4060		4	172	1238	192	237696					237696	Konfirmuar nga ASHK-ja	
<b>VLERA TOTALE</b>										16464		3218496	1076			2000800	3714	308262	5,233,990

**VENDIM****Nr. 550, datë 28.9.2023****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIM RRUGA LIDHËSE E AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË VLORËS (VIA), AUTOSTRADA FIER–VLORË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim rruga lidhëse e aeroportit ndërkombëtar të Vlorës (VIA), autostrada Fier–Vlorë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë” dhe “trull”, me një vlerë të përgjithshme prej 957 852 (nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 957 852 (nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e dy) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i

përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Vlorë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE E TË CILËVE PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PUBLIK “NDËRTIM RRUGA LIDHËSE E AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË VLORËS (VIA) AUTOSTRADA FIER–VLORË”

Nr. rendor	Pronari Emri i pronarit	Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Vlerësimet për shpronësim				Adresa	Shënime
		ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale	Sip. e shpronësimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (lekë/m <sup>2</sup> )	Vlera (lekë)	Vlera totale (lekë)		
1	Thimi Hyso	2813	146/1	arë	5200	456	204	93024	93,024.0	Novoselë	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Vllasi Hyso	2813	136/1	arë	2000	349	204	71196	71,196.0	Novoselë	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	Nije Llambro Kozma Llambro Natasha Llambro Entela Llambro Arberjan Llambro Eliona Llambro Gjenea Llambro	2813	148/1	arë	7800	434	204	88536	88,536.0	Novoselë	Konfirmuar nga ASHK-ja
4	Kristaq Moçka	2813	132/32	arë	1200	920	204	187680	187,680.0	Novoselë	Konfirmuar nga ASHK-ja
5	Mihallaq Dhomi Buzi	2813	123/1	arë	5244	462	204	94248	94,248.0	Novoselë	Konfirmuar nga ASHK-ja
6	Aleko Llanaj	2813	147/37	truall	3354	237	384	91008	91,008.0	Novoselë	Konfirmuar nga ASHK-ja. Mbi këtë truall ngrihet pasuria 147/37 ND, V.19, f. 28
7	Kastriot Sinanaj	2813	124/16	truall	8840	398	384	152832	152,832.0	Novoselë	Konfirmuar nga ASHK-ja
8	Shoq, Azurra Imobilare	2813	124/17	truall	1160	49	384	18816	18,816.0	Novoselë	Konfirmuar nga ASHK-ja
9	Shoq, Azurra Imobilare	2813	124/11	truall	8000	378	384	145152	145,152.0	Novoselë	Konfirmuar nga ASHK-ja
10	Shoq, Azurra Imobilare	2813	124/12	truall	730	40	384	15360	15,360.0	Novoselë	Konfirmuar nga ASHK-ja
<b>Vlera totale</b>						<b>3723</b>		<b>957,852</b>	<b>957,852.0</b>		





**VENDIM**  
**Nr. 551, datë 28.9.2023**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “KRIJIMI I NJË PARKIMI MAKINASH PRANË URËS SË VJETËR TË GORICËS”, BASHKIA BERAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Krijimi i një parkimi makinash pranë Urës së Vjetër të Goricës”, Bashkia Berat.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Berat.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 853 332 (tetëqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 853 332 (tetëqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekësh, përballohet nga Bashkia Berat.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Berat.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Berat.

8. Bashkia Berat kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Berat.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të Bashkisë Berat.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të Bashkisë Berat.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Berat, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME PRONË PRIVATE E TË CILËVE, SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “KRIJIMI I NJË PARKIMI MAKINASH PRANË URËS SË VJETËR TË GORICËS”, BASHKIA BERAT**

Nr. rendor	TË DHËNAT E PRONARIT	TË DHËNAT KADASTRALE				TË DHËNAT E SHPRONËSIMIT					ADRESA	Shënime
	Emër/Atësi/Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe totale e parcelës (m <sup>2</sup> )	Zëri kadastral	Volumi	Faqe	Sipërfaqe shpronësim (m <sup>2</sup> )	Çmimi në lek (m <sup>2</sup> )	Vlera totale e tokës në lekë	Bashkia	
1	Pavlo Kristaq Kusta	8502	4/307	20.4	Truall	15	139	20.4	4183	85,333.00	Berat	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Filip Anastas Sinjari Thimi Anastas Sinjari	8502	4/308	183.6	Truall	15	138	183.6	4183	767,999.00	Berat	Konfirmuar nga ASHK-ja
<b>Vlera totale</b>										<b>853,332.00</b>		



## VENDIM

Nr. 552, datë 28.9.2023

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.  
1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN NGA  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË  
VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË  
BASHKIMIT EVROPIAN, PËR  
VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE  
SHFUQIZIMIN E MASAVE  
SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE,  
TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në fund të pikës 20, të kreut I, shtohen fjalët “... i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2023/1188.”.

2. Në aneksin 20, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2023/1188, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**



VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2023/1188 i datës 19 qershor 2023 që ndryshon Vendimin 2014/386/CFSP në lidhje me masat kufizuese në përgjigje të aneksimit të paligjshëm të Krimesë dhe Sevastopolit

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë,

Ndërsa:

- (1) Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë <sup>(1)</sup>.
- (2) Bashkimi nuk njih dhe vazhdon të dënojë aneksimin e paligjshëm të Krimesë dhe Sevastopolit nga Federata Ruse si shkelje e ligjit ndërkombëtar. Bashkimi mbetet i palëkundur në angazhimin e tij ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht dhe i përkushtuar për zbatimin e plotë të politikës së tij të mosnjohjes.
- (3) Në bazë të një rishikimi të Vendimit 2014/386/CFSP, masat kufizuese të përcaktuara në të duhet të rinovohen deri më 23 qershor 2024.
- (4) Vendimi 2014/386/CFSP duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Në nenin 5 të Vendimit 2014/386/CFSP, paragrafi i dytë zëvendësohet si vijon:

Ky vendim do të zbatohet deri më 23 qershor 2024.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi një ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Luksemburg, 19 Qershor 2023.

Për Këshillin  
President

E. BUSCH

(1) Vendimi i Këshillit 2014/386/CFSP i 23 qershorit 2014 në lidhje me masat kufizuese në përgjigje të aneksimit të paligjshëm të Krimesë dhe Sevastopolit (OJ L 183, 24.6.2014, f. 70).



## COUNCIL DECISION (CFSP) 2023/1188

of 19 June 2023

**amending Decision 2014/386/CFSP concerning restrictive measures in response to the illegal annexation of Crimea and Sevastopol**

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 23 June 2014, the Council adopted Decision 2014/386/CFSP<sup>(1)</sup>.
- (2) The Union does not recognise and continues to condemn the illegal annexation of Crimea and Sevastopol by the Russian Federation as a violation of international law. The Union remains steadfast in its commitment to Ukraine's sovereignty and territorial integrity within its internationally recognised borders and dedicated to fully implementing its non-recognition policy.
- (3) On the basis of a review of Decision 2014/386/CFSP, the restrictive measures set out therein should be renewed until 23 June 2024.
- (4) Decision 2014/386/CFSP should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

*Article 1*

In Article 5 of Decision 2014/386/CFSP, the second paragraph is replaced by the following:

'This Decision shall apply until 23 June 2024.'

*Article 2*This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Luxembourg, 19 June 2023.

*For the Council*  
*The President*  
E. BUSCH

<sup>(1)</sup> Council Decision 2014/386/CFSP of 23 June 2014 concerning restrictive measures in response to the illegal annexation of Crimea and Sevastopol (OJ L 183, 24.6.2014, p. 70).

**KËRKESË****Nr. 281/16, datë 28.9.2023****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rehabilitimi i përroit Lushnjë dhe rikualifikimi urban i zonave rreth tij”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit “truall”, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për

miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehin nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Lushnjë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 5.834.380.9 (pesë milionë e tetëqind e tridhjetë e katër mijë e treqind e tetëdhjetë pikë nëntë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
KRYETAR I KOMISIONIT TË  
POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE  
**Egra Ibrahim**



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK,  
NGA PROJEKTI “REHABILITIMI I PËRROIT LUSHNJË DHE RIKUALIFIKIMI URBAN I ZONAVE RRETH TIJ”

Nr.	Pronari			Të dhëna hipotekore									Vlerësimet për shpronësim				Shënime (D+E) (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)			
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Truall (m <sup>2</sup> )	Ndërtesë (m <sup>2</sup> )	Volumi	Façe	Truall			Vlera totale (lekë)				
													Sipërfaqja (m <sup>2</sup> )	Çmimi (lek/m <sup>2</sup> )	Vlera (lekë)					
A	B	C	Ç	D	E	F	G	I	J	K	L	M	N	O	Y	Z				
1	FLAMUR SULEJMAN TAULLAI SUZANA VANGJEL TAULLAI			LUSHNJË	8572	19/36	TRUALL	260	260	112.5	28	41	22.4	8954	200569.6	200569.6	Në favor të Banka Credins. Konfirmuar nga ASHK-ja			
2	AGRON RAMAZAN SHEFA			LUSHNJË	8572	19/6	TRUALL	200	200	50	18	131	45.6	8954	408302.4	408302.4	Konfirmuar nga ASHK-ja			
3	GEN'TIAN XHEVIT TAULLAI			LUSHNJË	8572	19/37	TRUALL	200	200	108	28	94	1.4	8954	12535.6	12535.6	Konfirmuar nga ASHK-ja			
4	PERPARIM VAIT BASHLLARI MIRANDA AVDULLA BASHLLARI			LUSHNJË	8572	19/33	TRUALL	266.9	266.9	191.64	26	114	32	8954	286528	286528	Konfirmuar nga ASHK-ja			
5	MARKU PETRO DIMASHI			LUSHNJË	8572	5/3	TRUALL	380	380	105	12	10	47.5	8954	425315	425315	Konfirmuar nga ASHK-ja			
6	ALFRED JANI LALA ALMA DALIP LALA VLADIMIR JANI LALA ROZETA NDOI LALA MAKSIM JANI LALA ANILA THOMA LALA			LUSHNJË	8572	4/146	TRUALL	240	240	141			54	8954	483,516	483,516	Konfirmuar nga ASHK-ja			
7	ASPASIA PETRAQ DUSHI			LUSHNJË	8572	5/5	TRUALL	400	400	125			4	8954	35816	35816	Konfirmuar nga ASHK-ja			
8	FERDINANT MUSA BANI ALKETA MITI BANI			LUSHNJË	8572	5/4	TRUALL	260	260	115	13	222	37.8	8954	338461.2	338461.2	Konfirmuar nga ASHK-ja			
9	LUSHE QEMAL SHURDHII			LUSHNJË	8572	20/194	TRUALL	300	300	107.6	27	22	40	8954	358160	358160	Konfirmuar nga ASHK-ja			
10	THEMI LEKSI PRIFTI			LUSHNJË	8572	4/6	TRUALL	465	465	93.3	29	111	38.9	8954	348310.6	348310.6	Konfirmuar nga ASHK-ja			
11	ANDON KOSTANDIN MERTIKA			LUSHNJË	8572	19/14	TRUALL	200	200	105	29	111	13	8954	116402	116402	Konfirmuar nga ASHK-ja			
12	GËZIM FATMIR IDRIZI DRITAN FATMIR IDRIZI			LUSHNJË	8571	11/168	TRUALL	503	503		17	7	245	9709	2378705	2378705	Konfirmuar nga ASHK-ja			
13	GËZIM FATMIR IDRIZI DRITAN FATMIR IDRIZI			LUSHNJË	8571	11/169	TRUALL	437	437	0	17	8	45.5	9709	441759.5	441759.5	Konfirmuar nga ASHK-ja			
	SHUMA PARAPRAKE																	5834380.9	5834380.9	



*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë